VENDIM
Nr.1061, datë 8.7.2010

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, të ligjit nr.10 032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve" dhe të ligjit nr. 10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve janë sipas lidhjes nr.1, "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë mujore për gradë (kolona 3) e lidhjes nr.1, është niveli i pagës së punonjësit, në përputhje me gradën që ka fituar.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolonat 4, 5 e 6) të lidhjes nr.1, jepet sipas funksioneve të përcaktuara në këtë lidhje.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve me grada, për kohën e qëndrimit në gradë, përfiton shtesë për vjetërsi në punë, në masën 1 për qind, pas çdo viti pune. Masa e shtesës për vjetërsi në punë të jetë deri në nivelin e pagës bazë të gradës pasardhëse.

Përllogaritja e shtesës për vjetërsi në punë të fillojë në çastin e marrjes së gradës së re, sipas ligjit nr.10 032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve".

5. Vendimi nr.366, datë 14.6.2006 i Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve", të ndryshuar, shfuqizohet.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2010, për Policinë e Burgjeve.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

Roli	**Grada**	**Paga bazë për gradë**	**Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi**		
			Në funksion të policisë së regjimeve të jashtme, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksion të policisë së regjimeve të brendshme dhe transferim-shoqërimet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksion të policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Bazë	Nëninspektor	34000	4000	8000	
	Inspektor	38000	4000	8000	
	Kryeinspektor	43000	4000	8000	2000
I mesëm	Nënkomisar	52500	4000	8000	2000
	Komisar	57000	4000	8000	2000
	Kryekomisar	80000	4000	8000	2000
I lartë	Drejtues	92000			6500
	Drejtues i I-rë	95000			10000